



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr 2756 prot

Vlorë më 23/12 /2025

VENDIM

Nr 24 datë 22.12. 2025

**“MBI MIRATIMIN E KALENDARIT PËR HARTIMIN E PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028 DHE BUXHETIT VJETOR 2026 PËR
KËSHILLIN E QARKUT”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të Udhëzimit nr. 6/1, datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, si dhe të Udhëzimit nr. 23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”, Këshilli i Qarkut Vlorë

VENDOSI:

1. Të miratojë kalendarin e aktiviteteve të Programin Buxhetor Afatmësem 2026 -2028, si dhe të buxhetit të vitit 2026.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut dhe Grupi për Menaxhim Strategjik pranë Këshillit të Qarkut Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI

Ervis MOÇKA



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë nr 1245 prot, dt 05 / 01 /2026

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria” Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600

KALENDARI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM DHE BUXHETIT VJETOR 2026

Fazat		VEPRIMI PERKATES		Struktura Përgjegjëse	Afati
FAZA I	Hapi I	Përgatitja dhe shpërndarja e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor Përgatitja e raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për: a) dy vitet para vitit buxhetor; b) vitin buxhetor; c) tre vitet e ardhshme buxhetore. Paraqitet për shqyrtim e miratim në këshill raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për: a) dy vitet para vitit buxhetor; b) vitin buxhetor; c) tre vitet e ardhshme buxhetore.		Kryetari dhe struktura përgjegjëse për buxhetin	Deri më 31 dhjetor 2025
	Hapi II	Miratimi i raportit të vlerësimeve dhe të parashikimeve afatmesme të të ardhurave. 1. Shqyrtimi dhe miratimi i Deklaratës së Misionit. 2. Shqyrtimi dhe miratimi i strukturës së programeve. 3. Miratimi i kalendarit të brendshëm për realizimin e procedurave të PBA -së.		GMS	Deri më 31 Janar 2026
	Hapi III	Përgatitja e tavanëve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm. Këshilli i njësishë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.		Kryetari	Deri më 3 Mars 2026
	Hapi IV	GMS harton udhëzimin për përgatitjen e buxheit dhe kryetari e miraton dhe e shpërndan tek sektorët me: a) përcaktimin e programeve buxhetore dhe të ekipit të menaxhimit të programeve përkatëse; b) tavanet përgatitore të shpenzimeve në nivel programi për tre vitet e ardhshme; c) afatet e përgatitjes së kërkesave të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.		Këshilli i Qarkut Vlorë	Deri më 04 Mars 2026
	Hapi V	a. Përgatitja e një kalendarit të detajuar për fazën e parë të hartimit të kërkesave buxhetore në përputhje me kalendarin bazë të miratuar nga KQ. b. Rishikon strukturën e programeve të NJQV dhe ngjeshitë e nevojshme bën propozime për ndryshime. c. Dërgon kopje të udhëzimit vjetor të PBA, kalendarin dhe listën e EMP të të gjithë anëtarët e PBA-së.		Mbledhja e I dhe II të CMS	Deri më 11 Mars 2026
		Pas shpërndarjes së tavanëve përgatitore sipas programeve që përdor njësia belet përgatitja e projektit buxhetit afatmesëm sipas udhëzimit të miratuar nga Kryetari. Përgatitja e planeve të shpenzimeve, formulave të propozimit të projekteve të investimeve (FPP) dhe kërkesave për shpenzime shesë për çdo program dhe dorëzimi tek Kordinatori i CMS. Hartimi i kërkesave buxhetore dhe të gjithë formave përkatëse. Hartimi i relacioneve përkatëse nga çdo EMP.		GMS/Kryetari	Deri më 19 Mars 2026
				Nëpunësi zbatues në rolin e Sekretarit të CMS përgatit për Kryetarin dhe CMS	
				GMS/EMP	19 Maj 2026

PaZA II	Hapi VI	Dërgohet në Ministrinë e Financave projekttdokumenti i programit buxhetor afatmesëm. Ministria e Financave analizon dhe përgatit një raport me mendime mbi projekttdokumin e programit buxhetor afatmesëm dhe e sjell zyrtarisht në institucion. Shqyrtimi dhe miratimi i projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm, dhe opinioni i tij për rekomandimet e Ministrisë së Financave	Kryetari Ministria e Financave Këshilli i Qarkut Vlorë	3 Qershor 2026 22 Qershor 2026 19-30 Qershor 2026 6-10 Korrik 2026
	Hapi I	Publikimi i dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm të miratuar. Përgatitja e tavanave përfundimtare në nivel programi dhe hartimi i projekti vendimit për miratimin nga Këshilli i Qarkut me relacionin përkatës. Këshilli miraton tavanet përfundimtare	Kryetari Kryetari	8-14 Korrik 2026 Deri ne 21 Korrik 2026
	Hapi II	Kryetari i NJQV harton udhëzimin për përgatitjen e buxhetit dhe e shpërndan tek sektorët me: a) tavanet përfundimtare të shpenzimeve në nivel programi për tre vitet e ardhshme; b) afatet e përgatitjes së kërkesave të rishikuara të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.	Kryetari	25-31 Korrik 2026
	Hapi II	Rishikimi i projekt buxhetit afatmesëm dhe përgatitja e dokumentave përkatëse për në Këshill. Miratimi i projekt buxhetit të rishikuar Dërgimi në Ministrinë e Financave i dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, të miratuar nga këshilli i njësishë, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave gjatë fazës së parë. Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të programit buxhetor afatmesëm.	EMP/GMS/Kryetari Këshilli i Qarkut Vlorë Kryetari Ministria e Financave	2-8 Shtator 2026 Deri me 16 Shtator 2026 Deri me 15 Shtator 2026 20 Tetor 2026
Hapi III		Hartimi i projektbuxhetit vjetor me tabelat përkatëse dhe relacionet për miratim në Këshill. Pas marrjes së mendimeve përfundimtare dhe bashkërendimit me P-B vjetor Paraqitet për miratim në këshill projektbuxheti vjetor dhe PBA Propozojnë ndryshime të argumentuara të projektbuxhetit të paraqitur nga kryetari. Projekti i programit buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe buxheti i vitit të ardhshëm miratohet nga këshilli Publikimi i dokumentit të plotë të programit buxhetor afatmesëm, përfshirë dokumentacionin shoqërues Një kopje e buxhetit vjetor vendor dërgohet në Ministrinë e Financave	/GMS/ Drejtoria Ekonomike Kryetari Anëtarët e Këshillit të Qarkut Këshilli i Qarkut Vlorë Kryetari Kryetari	Deri ne 27 Nentor 2026 Deri ne 27 Nentor 2026 11 Dhjetor 2026 26 Dhjetor 2026 31 Dhjetor 2026 Jo më vonë se 5 ditë nga Miratimi në Këshill

	Publikimi i buxhetit vjetor me informacionin përkatës	Kryetari	Jo me vonë se 15 ditë nga miratimi në Këshill
--	---	----------	---

GMS:

Harallamb Pandehi

Kordinator i GMS

Anisa Hyseni

Drejtor i Drejtorisë së Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social

Mauricio Pashaj

Specialist Finance për Zbatimin e Buxhetit

Alma Myrtaj

Specialist Jurist

Blerina Lula

Specialist për Urbanistikën dhe Zhvillimin e Territorit

Ilda Lami

Specialiste për Arsimin, Kulturën, Turizmin, Çështjet Sociale dhe Zhvillimin e Projekteve

Vanina Vongli

Specialist për Zbatimin e Projekteve

Rea Shkreli

Specialist i Protokolli - Arkivës dhe Burimeve Njerëzore

Palush Naçi

Specialist për Shërbimet, Transportin dhe Emergjencat Civile

KRYETAR

ERVIS MOÇKA

